



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1010/23 Datë: 26/07/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
 1. *Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimet e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (A)</i>	Ylber Januzaj Donjeta Morina Valdrin Misiri

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Alexandre Tugui dhe Christofer Bohlens, është organizuar më 19.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtoj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

